



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 104 Prot

Tiranë, më 29/07 2010

VENDIM Nr. 11 dt. 27.07.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 27.07.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

- I. Lidhur me:** Diskutimi i draft rregullores së Qendrës Historike të qytetit të Beratit.  
**Miratohet:** "Rregullorja e mbrojtjes, konservimit të integruar dhe administrimit të Qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit"
- II. Lidhur me:** Shqyrtimi i manualit të çmimeve në restaurim për vitin 2010.  
**Miratohet:** Manuali i çmimeve në restaurim për vitin 2010.
- III. Lidhur me:** Diskutimi i projekteve të financuara nga buxheti i shtetit:
- Miratohet:** "Ndërhyrjet që do të realizohen në dyshtet e orkestrës së teatrit të Hadrianipolit, Sofratikë, Gjirokastër".
  - Miratohet:** "Projekt mirëmbajtje objekte monument kulture, për vitin 2010, Gjirokastër".

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR  
AKADEMIK APOLLON BAÇE